Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

05.12.2023, Prishtinë,
Ref:16.10.2023\1460-2023

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Shukrije Rama kundër Reporteri

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 29 nëntor 2023, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Shukrije Rama kundër Reporteri lidhur me publikimin e lajmit me titull " Anëtarja e bordit të RTK-së Shukrije Rama deklaroi 'rrejshëm' pasurinë, nisin hetimet", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M

Media ka publikuar një shkrim me titull “Anëtarja e bordit të RTK-së Shukrije Rama deklaroi ‘rrejshëm’ pasurinë, nisin hetimet”. Pala pretendon se shkrimi është në kundërshtim me Kapitullin II (raportimi i së vërtetës) të Kodit të Mediave.

Lajmi është shkrim i medias së shkruar, andaj ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMShK gjen se ankesa është e pabazuar. Pra, nuk miratohet.

KMShK e ka analizuar shkrimin e medias dhe ankesën e palës.

KMShK vëren se media ka paraqitur para publikut një hulumtim mbi deklarimin e pasurisë së ankueses.

Sipas gjetjeve nga ana e medias, e të konfirmuara në shkrim edhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, por edhe nga vetë pala, del se hulumtimi është në rregull dhe se raportimi është i vërtetë.

KMShK gjatë leximit të titullit dhe të nëntitujve brenda shkrimit gjen se termi i përdorur “hetim” mund të jep konotacion negativ në kuptimin penal apo të kryerjes së veprës penale. Mirëpo, marrë shkrimin në tërësi, atëherë bëhet fjalë për hetimin administrativ që e ka filluar Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, sipas mandatit që ka. Ky insitucion ka të drejtë fillimin e procedurave të hetimit administrativ të çdo zyrtari shtetëror, ashtu si edhe në rastin konkret.

Andaj, KMShK vendos që ankesa të mos miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës